

VENDIM
Nr.587, datë 8.12.1999

**PËR SHKËPUTJEN NGA PUNA TË SPORTISTËVE E TË SPECIALISTËVE TË SPORTIT,
PËR PJESËMARRJE NË VEPRIMTARITË SPORTIVE DHE GJATË PËRGATITJES PËR
TO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sportistët dhe specialistët e sportit të të gjitha kategorive, që janë punonjës në institucione shtetërore, lejohen të shkëputen nga puna për pjesëmarrjen në veprimtari të sportive, kombëtare e ndërkombëtare, dhe gjatë përgatitjeve për to. Pagesa për ditët e shkëputjes nga puna do të bëhet nga institucioni, ku ata janë punësuar.

2.Sportistët dhe specialistët e sportit, që përmenden në pikën 1, kanë të drejtë të shkëputen nga puna deri në 60 ditë pune në vit. Shkëputje për periudha më të gjata bëhet me marrëveshje ndërmjet federatës përkatëse, sportistit apo specialistit dhe institucionit shtetëror, ku ai punon. Pagesa në këtë rast bëhet federata, sipas pagës që merr i interesuari në institucionin shtetëror, ku ai është i punësuar.

3.Sportistët dhe specialistët, të punësuar në institucione apo shoqëri tregtare, shkëputen në bazë të marrëveshjes ndërmjet federatës, sportistit apo specialistit dhe institucionit apo shoqërisë tregtare ku ai punon. Federata përkatëse në këtë rast ka të drejtë të paguajë sportistin apo specialistin sipas pagesës zyrtare që ai merr nga punëdhënësi privat.

4.Për nxënësit dhe studentët, që marrin pjesë në veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, mungesat e shkaktuara nga pjesëmarrja në këto veprimtari quhen të justifikuara, por pa kaluar 25 për qind të shumës vjetore të orëve.

5.Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi të nxjerrë udhëzim të veçantë.

6.Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.188, datë 25.4.1995 dhe nr.359, datë 10.7.1995 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta